



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:189199

Datë: 07.02.2024

Numri i dokumentit: 05295118

Ac.nr.7063/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti kryetare e kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Besnik Bislimaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve B.K., S.Sh., Q.K., H.D., N.Y., A.D., I.K., G.D., N.N., dhe I.K., që të gjithë nga K..... e M....., Komuna Rahovec, të cilët me autorizim i përfaqëson D.M., avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec, të cilën me autorizim e përfaqëson B.O., avokat nga Rahoveci, me objekt kontesti kompensimin e shujtave ditore dhe shpërblimit jubilar, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec, C.nr.874 /2021, të datës 26.05.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.02.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET pjesërisht e pathemeltë ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të së paditurës Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit me seli në Rahovec, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec, C.nr.874 /2021, i datës 26.05.2022, në pikën një të dispozitivit në pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë me të cilën është *Detyruar* e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec, që paditësve B.K., S.Sh., Q.K., H.D., N.Y., A.D., I.K., G.D., N.N., dhe I.K., që të gjithë nga K..... e M....., Komuna Rahovec, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për 111 ditë pune, t'ua paguajë secilit veç e veç shumën prej 222.00 €uro, dhe në emër të shpërblimit jubilar paditësit N.Y., për 41 vitet të përvojës së punës, shumën prej 730.48 € dhe paditëses I.K., për 30 vitet të përvojës së punës, shumën prej 481.98 €, **VËRTETOHET**.

II. APROVOHET pjesërisht e themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec, C.nr.874 /2021, i datës 26.05.2022, në pikën një të dispozitivit, në pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë së paditësve H.D., A.D., G.D., N.N., dhe I.K., përkitazi me kompensimin e shpërblimit jubilar, ashtu që për këtë pjesë gjykohet si në vijim: **REFUZOHET** pjesërisht si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve H.D., A.D., G.D., N.N., dhe I.K., që të gjithë nga K..... e M....., Komuna Rahovec, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna

e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec, që paditësve t'ua kompensoj në emër të shpërblimit jubilar paditësit Haxhi Dellova, për 34 vitet të përvojës se punës shumën 489.15 €, paditësit A.D., për 33 vite përvojë pune, shumën prej 487.35 €, paditëses G.D., për 27 vite përvojë pune, shumën prej 357.45 €, paditëses N.N., për 28 vite përvojë pune, shumën prej 358.80 €, dhe paditësit I.K., për 38 vite përvojë pune, shumën prej 496.35 €.

III. Pika dy e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec, C.nr.874 /2021, i datës 26.05.2022, mbetet e pashqyrtuar (papakur).

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar ka vendosur si vijon:

“APROVOHET padia dhe kërkesëpafia e paditësve **B.K., S.Sh., Q.K., H.D., N.Y., A.D., I.K., G.D., N.N., I.K.,** si dhe detyrohet e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësve t'ua paguaj kompensim në emër të ushqimit gjatë punës në lartësi prej 2,00€ për një ditë pune dhe në emër të pagave jubilarë për vitet jubilarë për secilin paditës si vijon : paditësit **B.K.,** në emër të shpenzimeve për ushqim gjatë periudhës kohore prej 01.01.2020 e deri 31.12.2020 për gjithsejtë 111 ditë pune, në vlerë prej 2,00 € për një ditë pune, shumën prej 222,00 €, Paditëses **S.Sh.,** në emër të shpenzimeve për ushqim gjatë periudhës kohore prej 01.01.2020 e deri 31.12.2020 për gjithsejtë 111 ditë pune, në vlerë prej 2,00 € për një ditë pune, shumën prej 222,00 €, paditëses **Q.K.,** në emër të shpenzimeve për ushqim gjatë periudhës kohore prej 01.01.2020 e deri 31.12.2020 për gjithsejtë 111 ditë pune, në vlerë prej 2,00 € për një ditë pune, shumën prej 222,00 €, paditësit **H.D.,** në emër të shpenzimeve për ushqim gjatë periudhës kohore prej 01.01.2020 e deri 31.12.2020 për gjithsejtë 111 ditë pune, në vlerë prej 2,00 € për një ditë pune, shumën prej 222,00 €, ndërsa në emër të kompensimit për shpërblim jubilar për 34 vitet të përvojës se punës shumën 489.15 €. (100% të pagës), paditësit **N.Y.,** në emër të shpenzimeve për ushqim gjatë periudhës kohore prej 01.01.2020 e deri 31.12.2020 për gjithsejtë 111 ditë pune, në vlerë prej 2,00 € për një ditë pune, shumën prej 222,00 €, ndërsa në emër të kompensimit për shpërblim jubilar për 41 vitet të përvojës se punës shumën 730.48 €. (150% të pagës), paditësit **A.D.,** në emër të shpenzimeve për ushqim gjatë periudhës kohore prej 01.01.2020 e deri 31.12.2020 për gjithsejtë 111 ditë pune, në vlerë prej 2,00 € për një ditë pune, shumën prej 222,00 €, ndërsa në emër të kompensimit për shpërblim jubilar për 33 vitet të përvojës se punës shumën 487.35 €, paditëses **I.K.,** në emër të shpenzimeve për ushqim gjatë periudhës kohore prej 01.01.2020 e deri 31.12.2020 për gjithsejtë 111 ditë pune, në vlerë prej 2,00 € për një ditë pune, shumën prej 222,00 €, ndërsa në emër të kompensimit për shpërblim jubilar për 30 vitet të përvojës se punës shumën 481.98 €. (100% të pagës), paditëses **G.D.,** në emër të shpenzimeve për ushqim gjatë periudhës kohore prej 01.01.2020 e deri 31.12.2020 për gjithsejtë 111 ditë pune, në vlerë prej 2,00 € për një ditë pune, shumën prej 222,00 €, ndërsa në emër të kompensimit për shpërblim jubilar për 27 vitet të përvojës se punës shumën 357.45 € (75% te pagës), paditëses **N.N.,** në emër të shpenzimeve për ushqim gjatë periudhës kohore prej 01.01.2020 e deri 31.12.2020 për gjithsejtë 111 ditë pune, në vlerë prej 2,00 € për një ditë pune, shumën prej 222,00 €, ndërsa në emër të kompensimit për shpërblim jubilar për 28 vitet të përvojës se punës shumën 358.80 €. (75% te pagës), paditësit **I.K.,** në emër të shpenzimeve për ushqim gjatë periudhës kohore prej 01.01.2020 e deri 31.12.2020 për gjithsejtë 111 ditë pune, në vlerë prej 2,00 € për një ditë pune, shumën prej 222,00 €, ndërsa në emër të kompensimit për shpërblim jubilar për 38 vitet të përvojës se punës shumën 496.32 € (100% te pagës), e në shumën e përgjithshme për të gjithë paditësit prej 5,621.53 €, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë nga data (28.07.2021), e deri në pagesën

definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, SI ME BAZË.

DETYROHET e paditura që në po të njëjtin afat, paditësit t'i paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej **1,050.60 €** me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm''.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës material, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën duke e refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve, apo të prishë në tërësi aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthej në rigjykimin e shkallës së parë .

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësve me përgjigje në ankesë ka propozuar që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është pjesërisht e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit nëpërmes të autorizuarit kanë ushtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësve t'ua kompensoj në emër të shujtave ditore data 01.01.2020 e deri me datë 31.12.2020, nga 2 euro në ditë, ndërsa me parashtrësën e precizuar të datës 26.04.2022, ka zgjeruar kërkesëpadinë edhe sa i përket kompensimit të shpërblimit jubilar për paditësit H.D., N.Y., A.D., I.K., G.D., N.N., dhe I.K., sipas viteve të përvojës së punës sipas provave bashkëngjijt parashtrësës, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësve pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqës, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimin të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimin, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë. Nuk mund të pranohet pretendimi për këtë shkelje sepse ndryshimi i aktgjykimin ka të bëjë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale

e jo me arsyetimin e gabuar. Zbatimi i gabuar i të drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë e ka përcaktuar edhe arsyetimin e aktgjykimit për kompensimin e pagave jubilarë në atë mënyrë që përfundimi meritor është arsyetuar në përputhje me dispozitat e LPK-së, pavarësisht se një përfundim të tillë të gjykatës së shkallës së parë, gjykata ankimore e ka ndryshuar në një pjesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në konstatimin e gabuar të gjendjes faktike, ngase gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike me provat e administruara, ngase nuk ka qenë kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe të njëjtit kanë 111 ditë pune nga data 01.01.2020 e deri me datë 31.12.2020, fakte këto të cilat i vërtetoi nga vërtetimet e lëshuara nga Shkollën “B..... C.....”, ne fshatin K..... e M....., Komuna Rahovec, po ashtu nuk ishte kontestuese përvoja e punës së paditësve në këtë shkollë fakt i vërtetuar nga Lista e pagave të BRK-së, kontestuese për të paditurën ishte se nuk kishin të ndarë linjë buxhetore të caktuar për pagesën e këtyre shpërblimeve.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin shpenzimeve të ushqimit ditor drejtë ka zbatuar të drejtën materiale dhe me të drejtë është bazuar në dispozitën e nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 ku parashihet që *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore e duke u bazuar në këtë gjendje faktike Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar të drejtën materiale përkitazi me kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë për periudhën kohore nga data 01.01.2020 e deri me datë 31.12.2020, e cila për qëndrimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara, bindëse faktike dhe juridike për faktet vendimtare për vendosje në këtë çështje juridike.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për pagesën e shpërblimit jubilar për paditësin N.Y., dhe I.K., sepse nga Lista e pagave të BRK-së, për periudhën 01 Maj 31 Maj 2017, vërtetohet se paditësi N.Y., ka 38 vite përvojë pune, ndërsa nga lista e pagave me numër EMXXXX, vërtetohet se ka 41 vite përvojë pune, ndërsa jubileun e katërtë e ka arritur në vitin 2019, ndërsa nga kjo listë po ashtu vërtetohet se paditësja I.K., ka 30 vite përvojë pune dhe jubileun e tretë e ka arritur në vitin 2020, andaj gjykata me të drejtë e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit N.Y., dhe I.K., për shpërblim jubilar dhe ndaj këtyre paditësve një kërkesë e tillë nuk është e parashkruar, pasi që padinë e kanë ushtruar me datë 17.08.2021, brenda afatit të përcaktuar me dispozitën e nenit 87 të Ligjit të Punës në Kosovë Nr.03/L-212.

Gjithashtu, bazuar në nenin 35 paragrafin 8, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 përcaktohet se: *“Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: pika 8.4. për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150% të një page bazë, ndërsa pika 8.5. përcakton se: Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuarit ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse, 8.6. Shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti”*.

Përkitazi me kërkesëpadinë e paditësve H.D., A.D., G.D., N.N., dhe I.K., për kompensimin e shpërblimit jubilar, Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për çka është dashur që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar.

Në këtë rast gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 35 paragrafi 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 kur paditësit i ka njohur të drejtën për kompensimin e shpërblimit jubilar, me të cilën shprehimisht parashihet se: *“Punëtorët (anëtar të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i tyre i fundit, për 10 vjet të përvojës së punës, në vlerë të 50% të një page bazë, për 20 vjet të përvojës së punës, në vlerë të 75 % të një page bazë, për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë dhe për 40 vjet të përvojës së punës, në vlerë të 150 % të një page bazë”*. Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuarit ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse.

Kjo dispozitë përcakton të drejtën e punëtorit për shpërblim jubilar, mirëpo në rastin konkret themelësia e kësaj pjese të kërkesëpadisë nuk ka mundur të mbështetet në këtë dispozitë për shkak se kërkesa është parashkruar dhe prapësimin e parashkrimit e ka paraqitur e paditura me rastin e dhënies së përgjigjes në padi.

Gjykata e Apelit duke e vlerësuar pretendimin e të paditurës për parashkrim, gjen se në këtë çështje juridike kontestuese kërkesa e paditësit për kompensimin e shpërblimit jubilar është parashkruar për çka vendosi që ta refuzoj si të pa bazuar këtë pjesë të kërkesëpadisë. Në këtë rast Gjykata e Apelit i është referuar dispozitës së nenit 87 të Ligjit të Punës në Kosovë Nr.03/L-212 me të cilën përcaktohet afati i parashkrimit për kërkesat nga marrëdhënia e punës, me të cilën dispozitë në mënyrë specifike përcaktohet se: *të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*.

Në rastin konkret nga shkresat e lëndës gjegjësisht nga Lista e pagave të BRK-së, për periudhën 01 Maj 31 Maj 2017, rezulton se paditësi H.D., ka përvojë pune tek e paditura 34 vite përvojë pune, ndërsa jubilen e tretë e ka arritur në vitin 2016, paditësi A.D., i ka 33 vite përvojë pune, ndërsa jubilen e tretë e ka arritur në vitin 2017, paditësja G.D., ka 27 vite përvojë pune, ndërsa jubilen e dytë e ka arritur në vitin 2013, paditësja N.N., i ka 28 vite përvojë pune, jubilen e dytë e ka arritur në vitin 2012 dhe paditësi I.K., i ka 38 vite përvojë pune, jubilen e tretë e ka arritur në vitin 2012, ndërsa padinë në gjykatë e kanë ushtruar me dt. 18.07.2021, që rezulton se nga koha kur paditësit e kanë arritur jubileun e dytë dhe të tretë e deri në datën e paraqitjes së padisë në gjykatë kanë kaluar më shumë se 3 vite, nga çka rezulton se kërkesa e padisë për këtë pjesë është parashkruar. Prandaj nga arsyet e theksuara gjykata ankimore duke vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit për shpërblim jubilar nuk ka bazë ligjore, me referim në dispozitën e nenit 195, par. 1 pika e), lidhur me nenin 201 par. 1, pika d) të LPK-së vendosi që aktgjykimin në pjesën përkatëse ta ndryshoj me refuzimin e kërkesëpadisë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se e njëjta nuk është nënshkruar e Kontratës Kolektive të Arsimit dhe se rrjedhimisht nuk ka marrë obligimet për të zbatuar këtë kontratë, për faktin se sipas vlerësimit të gjykatës ankimore me dispozitën e nenit 2 paragrafi 1 pika 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë përcaktohet se: *“1. Dispozitat e kësaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të*

gjitha institucionet publike dhe private të arsimit para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”, ndërsa me nën paragrafin 1.2 përcaktohet se: “Dispozitat e kësaj kontrate, janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”.

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 46 të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruesit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa shpenzimet e procedurës janë gjykuar në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve e gjithashtu në harmoni me dispozitat ligjore.

Pika dy e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës, nuk është shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Apelit, pasi që kjo pjesë e dispozitivit të aktgjykimit nuk është atakuar me ankesë.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit në bazë të nenit 194, 195 par.1 pika d) dhe e) lidhur me nenin 201 par.1 pika d) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7063/2022, me datë 06.02.2024

**Kryetare e Kolegjit
Naime Ahmeti d.v**